



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 410-33027

Më datë 10.06.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr.01/2025 për mekanizmin koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore dhe nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016" Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin mekanizmit koordinues lokal

1. Me qëllim të ofrimit të sigurisë, parandalimin, trajtimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, formohet mekanizmi koordinues lokal në këtë përbërje:
 - 1.1 Bali MUHARREMAJ-----Kryetar i Komunës
 - 1.2 Besa KUQI-----Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - 1.3 Mirlinda SPAHIJA-----Qendra për punë sociale
 - 1.4 Remzi BAJSELMANI-----Drejtor i Arsimit
 - 1.5 Habibe BYTYQI-----Zyrtare për barazi gjinore
 - 1.6 Sale BYTYQI-----Drejtoresh e QKMF-së
 - 1.7 Xheladin SADIKAJ -----Përfaqësues i zyrës për komunitetet dhe kthim
 - 1.8 Julibea KABASHI-----Përfaqësuese e Strehimores në Prizren
 - 1.9 Erza MUQA-----Përfaqësuese e OJQ fuqizimi i gruas dhe rinis, Suharekë
2. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, pjesë të mekanizmit koordinues lokal ftohen të jenë:
 - 2.1 Selajdin GALLAPENI-----Kryetar i Gjykatës Themelore dega në Suharekë
 - 2.2 Mehreme HOXHA-----Prokurore në Prokurorin Themelore në Prizren
 - 2.3 Afrim SYLAJ-----Komandant i Stacionit Policor në Suharekë
 - 2.4 Ali AHMETI-----Mbrojtës i viktimave
 - 2.5 Avni BYTYÇI-----Koordinator i KKS-së
 - 2.6 Veton HALILI-----Zyra për ndihma juridike falas
 - 2.7 Mehreme Hoxha-----Zyra komunale për punësim
 - 2.8 Sali BLLACA-----Drejtor i qendrës së shëndetit mendor
3. **znj. Habibe Bytyqi** sipas detyrës zyrtare caktohet sekretare e Mekanizmit koordinues lokal për mbështetje administrative teknike.
4. Detyrat e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore janë të përcaktuara me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
5. Ky vendi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë dhe e shfuqizon vendimin me numër 01-Nr-016-10141 të datës 16.02.2022.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

I dorëzohet:
Anëtarëve të këshillit,
Në dosje